



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2790/ 2 prot

Datë 14.12.2022

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

- Objekti:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE*” SHPK në procedurën e prokurimit “*E hapur, e thjeshtuar*” me nr REF-48990-11-07-2022 me objekt “**Rikonstrukcion dhe adaptim i ish kopshtit Verbas në Qëndër Ambulatore.**” me fond limit 2,900,000.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 18-11-2022 nga autoriteti kontraktor Bashkia Patos
- Ankimues:** MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SHPK
Rruga e Durrësit, Hyrja Nr.3, Pasuria e llojit Bodrum, Nr.4/12+3-B/1, Zona Kadastrale 8210
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Patos
Lagja “Naftëtari”, Rruga “Unaza, Patos

Në datën 13.12.2022 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është paraqitur në mënyrë elektronike në Sistemin e Ankesave Elektronike ankesa me nr. A/2022/2771 , protokolluar me nr. 2790/2022 datë 13.12.2022 e operatorit ekonomik “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me nr REF-48990-11-07-2022 me objekt “Rikonstrukcion dhe adaptim i ish kopshtit Verbas në Qëndër Ambulatore.” me fond limit 2,900,000.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 18-11-2022 nga autoriteti kontraktor Bashkia Patos.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SHPK

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: *“Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”*

Komisioni i Prokurimit Publik publikon arsyet e skualifikimit për të cilat operatori ekonomik ankimues “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SHPK në ankesën nr 2790/2022 datë 13.12.2022, pretendon se i përmbush.

Arsyet e Skualifikimit nga AK:

Ju skualifikohen pasi nuk plotesoni kriterin e vecantë të kualifikimit pika 2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet, pasi trapano elektrike janë kërkuar dy ju keni deklaruar vetëm një në formualrin e vetëdeklarimit. Dhe referuar faturës me nr.40 datë 28.01.2014 të ngarkuar në sistem silësohet trapano pneumatike, jo trapano elektrike

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 14.12.2022

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri